

## **PROGRAMI**

### **VJETOR I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2018**

#### **PËRMBAJTJA**

1. Hyrja .....
2. METODOLOGJIA E PROGRAMIT .....
3. MBLEDHJET .....
4. TRYEZA E RRUMBULLAKTË ...
5. MONITORIMI I PUNËS SË INSTITUCIONEVE KOMUNALE .....
6. TRAJNIMET .....
7. VIZITAT .....
8. AKTIVITETET .....
9. INFORMIMI .....
10. REZYMEJA E PROGRAMIT ....

#### **HYRJE**

Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara i Komunës së Prishtinës (më tej në tekst: Komiteti), i përzgjedhur nga Panelli Intervistues Komunal, konform nenit 48 të Statutit të Komunës së Prishtinës, me datë 24.03.2016. ka për fushëveprim nxitjen, mbrojtjen dhe sigurimin e mundësisë që të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Prishtinës t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, sa u përket specifikave të këtyre personave dhe sa i përket domenit të nivelit komunal të qeverisjes.

PAK përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barrierat e ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Orientimet e përgjithshme programore të Komitetit janë: Dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarrura nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse \* Paraqitja e

pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve persona me aftësi të kufizuara tek Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës \* Propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Pra, **misioni i Komitetit është të jetë** një hallkë ndërlidhëse mes Personit me Aftësi të Kufizuar, si individ, pastaj, organizatave joqeveritare që i përfaqësojnë këta persona, në njërin anë, si dhe të Institucioneve të Komunës së Prishtinës, në anën tjetër, me qëllim të avancimit të të drejtave të këtij komuniteti, përmes debatit, hulumtimit të rastit, analizës së gjithëmbarshme tematike, si dhe avokimit për gjithëpërfshirje në jetën shoqërore.

Komiteti për punën dhe aktivitetet e veta i përgjigjet dhe i raporton Komunës.

Sipas metodologjisë së vet, ky program vjetor i punës për vitin 2018 parasheh seanca të rregullta, tryezë të rrumbullaktë, vizita të ndërsjella, si dhe aktivitete të nduar-nduarta ndërkomunitare.

## **Metodologjia e programit**

### **1. Mbledhjet**

Konform Udhërrefyesit të vet dhe në harmoni me Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, Komiteti për vitin 2018 ka paraparë gjashtë (6) Seanca të Rregullta, në të cilat do të shqyrtohen tematika që kanë të bëjnë me situatën dhe problematiken e Personave me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Prishtinës.

Duke qenë se kapacitetet e anëtarëve të Komitetit prej më së një vviti nga konstituimi tash më janë ngritur, seancat do ta shqyrtojnë vetëm situatën në hapsirën kohore nga mbledhja paraprake dhe do t'i propozojë masat konkrete për periudhën gjer në mbledhjen e radhës, përveç prioriteteve të dala jashta projeksioneve programore.

Seancat do të caktohen dhe mbahen në këto interval kohore: java e fundit e muajit janar, java e fundit e muajit mars, java e fundit e muajit qershor, java e parë e muajit shtator, java e parë e muajit nëntor dhe java e parë e muajit dhjetor.

### **2. Tryeza e rrumbullaktë**

Çdo vit, Komiteti organizon nga së paku një tryezë të rrumbullaktë, me qëllim të identifikimit dhe diskutimit të çështjeve me të cilat ballafaqohen Personat me Aftësi të Kufizuara në përgjithësi dhe që janë në kompetenca të komunës për tu zgjidhur.

Për këtë vit, Komiteti organizon tryezë të rrumbullaktë me temë “Implementimi i legjislacionit për Persona me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Prishtinës”.

Pjesëmarrës në këtë tryezë do të ftohen të jenë përfaqësues institucionesh publike, organizatat joqeveritare komunitare, si dhe të shoqërisë civile që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Tryeza do të mbahet në javën e dytë të muajit mars dhe do të ketë mbulueshmëri mediale.

Komiteti do të nxjerrë dhe publikojë konkluzionet e dala nga kjo tryezë.

### **3. Monitorimi i punës së institucioneve komunale për zbatimin e legjislacionit**

Në mënyrë që të sigurohet që legjislacioni që ka të bëjë me Personat me Aftësi të Kufizuara të mos mbetet vetëm në letër, Komiteti bën monitorimin aktiv të implementimit të atij legjislacioni, përmes takimeve mujore me institucionet, si dhe përmes bisedave joformale me zyrtarët e tyre.

Pjesë e këtij monitorimi do të jetë edhe zbatimi në praktikë i konkluzioneve dhe rekomandimeve të mbledhjeve të Komitetit dhe të konkluzioneve dhe të rekomandimeve të tryezës së rrumbullaktë.

#### **4. Trajnimet**

Në sensin e ngritjes permanente, Komiteti organizon trajnime për anëtarët e vet, të cilat trajnime ndahen në dy fusha:

**4.1. Në fushat e avokimit** – trajnimi do të përfshijë identifikimin e nevojave dhe përfaqësimin e interesave të komunitetit para institucioneve komunale.

**4.2. Në marrëdhënie me publikun dhe rritje të vizibilitetit** – trajnimi do t'u shërbejë anëtarëve të Komitetit për të ngritur dhe publikuar çështjet me të cilat ballafaqohen Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës.

**4.3. Në fushën e hulumtimit dhe të raportimit** – në mënyrë që anëtarët e Komitetit të jenë në gjendje të mësojnë problemet e fshehta të mospërbushjes së nevojave të konstituentëve, si dhe të raportojnë ato probleme para publikut. Kjo pjesë e aktivitetit do të përkrahet edhe me trajnimin për rritjen e aftësive komunikuese për anëtarët e Komitetit, në mënyrë që të rritet efikasiteti i tyre në bartje të informatave.

Kohëzgjatja e trajnimit është dy (2) javë, ndërsa afati kohor është muaji tetor.

#### **5. Vizitat**

Në kuptim të njohjes sa më të mirë të trajtimit të çështjes së aftësisë së kufizuar nga institucionet publike, nga shoqëria civile, si dhe nga vetë ata, gjatë vitit 2018, Komiteti ka paraparë:

**5.1. Vizita të ndërsjella Institucioneve Komunale të Prishtinës**, me qëllim të rritjes së involvimit të Personave me Aftësi të Kufizuara në procesin e vendimmarrjes, përmes angazhimit edhe në komisionet e përhershme dhe ato konsultative të komunës së Prishtinës.

Afatet kohore të këtyre vizitave të ndërsjella do të harmonizohen me agjendat e institucioneve përkatëse.

**5.2. Vizita organizatave joqeveritare që përfaqësojnë Persona me Aftësi të Kufizuara**, për t'i dëgjuar kërkesat dhe propozimet e tyre për Komunën e Prishtinës, në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara të nivelit komunal të qeverisjes.

Afatet kohor për realizimin e këtyre vizitave caktohen sipas një radhitje dhe në marrëveshje me secilën organizatë joqeveritare.

**5.3. Vizita entiteteve homologe jashtë vendi**, bëhen në kryeqendrat në rajon dhe më gjerë, së paku një (1) e tillë gjatë vitit dhe realizohet me qëllim të këmbimit të përvojave pozitive në kadrin ligjor, në zbatueshmërinë e tij, në organizimin dhe rolin e entiteteve të aftësisë së kufizuar atje, si dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit të aftësisë së kufizuar në rrjedhat shoqërore dhe jetën publike.

## **6. Aktivitetet**

Në vazhden e bashkëpunimit ndërkomunitar, Komiteti, si trup ambrellë për mbrojtjen dhe avansimin e të drejtave dhe interesave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës, organizon aktivitete të ndryshme në ditë të shënuara, të cilat aktivitete manifestohen me gara sportive dhe me shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara.

**6.1. Gara Komunale në Shah për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës**, organizohet nga Komiteti me rastin e 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Prishtinës. Në këtë eveniment ftohen të marrin pjesë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar në nivelin lokal.

**6.2. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara**, manifestohet nga Komiteti me rastin e 3 dhjetorit, në të cilin eveniment ftohen të marrin pjesë përfaqësuesit e të gjitha llojeve të aftësisë së kufizuar në nivelin lokal.

## **7. Informimi**

Komiteti, përveç se për punën dhe aktivitetet e veta i raporton me shkrim Kuvendit Komunal të Prishtinës në baza vjetore dhe përmes raportimit për një temë të veçantë mbi komunitetin e aftësisë së kufizuar, për transparencë dhe për informim të drejtë të palëve të interesit:

**7.1. Komiteti, Tërë punën dhe aktivitetet e veta i publikon në Faqen Zyrtare të Komunës së Prishtinës; si dhe**

**7.2. Komiteti krijon marrëdhënie me mediet e shkruara dhe audio-vizuele për përcjelljen e punëve dhe aktiviteteve të tij, si dhe për promovimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës, duke reaguar aty ku ato të drejta nuk përfillen apo edhe cenohen.**

## **REZYMEJA E PROGRAMIT**

Realizimi i këtij programi do të sigurojë që Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës të kenë një adresë të caktuar në të cilën t'i ngrisin çështjet me të cilat ata ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme. Kjo do të arrihet edhe përmes formësimit dhe fuqizimit të rolit të Komitetit, i cili përherë do të ketë për target Personat me Aftësi të Kufizuara në tërë territorin e Komunës së Prishtinës dhe do të merret ekskluzivisht me problemet e tyre.

Themelimi dhe fuqizimi i një organi të këtillë, i cili ka për qëllim avancimin e pozitës së këtij komuniteti, do të jetë një hap i madh përpara në përmirësimin e gjendjes së tyre në Komunën e Prishtinës.

Me realizimin e këtij programi vie gjer tek ngritja e kapacitetit dhe efikasitetit të punës së Komitetit, në drejtim që anëtarët e tij të jenë më proaktivë në mbrojtjen e interesave të komunitetit të tyre.

Përfundimisht dhe pasi që Komiteti është entitet institucional dhe i njeh specifikat e secilit komunitet të aftësisë së kufizuar dhe të tërë komunitetit të aftësisë së kufizuar, përmes këtij programi, i cili do t'i nënshtrohet një shqyrtimi komunitar, do të mund të arrihet gjer tek unifikimi dhe thjeshtëzimi i kërkesave dhe nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Prishtinë dhe më gjerë.